

## REKOMANDIMET TONA PER SESIONIN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË DATA 25-27 SHTATOR 2015 NË NEW YORK

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe UNFPA me mbështetjen, edhe të koalicionit për Çështjet e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues e konsiderojnë të domosdoshëm adresimin e rekomandimeve të mëposhtme në Sesionin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në data 25-27 shtator 2015 në New York.

1. Ne vlerësojmë që në kuadër të miratimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Shqipëria duhet të shprehë mbështetjen e fortë për objektivin 3 dhe përfshirjen në të të qasjes universale në shërbime të kujdesit shëndetësor riprodhues, shëndetit të nënës, AIDS e më gjerë si dhe objektivin 5 që i referohet diskriminimit ndaj grave dhe vajzave, dhunës me bazë gjinore, praktikave të dëmshme përfshirë dhe martesat e hershme dhe të detyruara. Si një mbrojtëse e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore është thelbësore që Shqipëria të tregojë mbështetjen e saj për përmirësimin e të drejtave dhe shëndetit seksual dhe riprodhues përfshirë edhe edukimin seksual gjithëpërfshirës nën Objektivin 3.7 . Gjithashtu Shqipëria duhet të mbështesë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat në tërësi, përfshirë qasjen për abort, orientimin seksual dhe identitetin gjinor edhe nën objektivin 5.6.
2. Ne po ashtu shprehemi që Shqipëria duhet të mbështesë aftësimin dhe edukimin për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut në Objektivin 4; punësimin e të rinjve si element kryesor në dividentin demografik – në objektivin 8; të adresojë gjerësisht pabarazitë dhe diskriminimin , përfshirë edhe për emigrantët në Objektiv 10; të përfshijë urbanizimin në Objektin 11 dhe të sigurojë pjesëmarrjen dhe mbrojtjen nga nga dhuna në Objektiv 16; sisteme të forta të dhënash në Objektivin 17.

Procesi i Post -2015 vazhdon me Samitin e OKB-së në shtator, ku rezultati do të miratohet zyrtarisht, me Negociatat e OKB-së për Ndryshimet Klimatike në dhjetor, dhe çfarë është më e rëndësishmja, me formulimin e treguesve si pjesë e kornizës së monitorimit, si dhe përpunimin e mëtejshëm të mekanizmit të vazhdimësisë dhe rishikimit të kësaj Axhende. Eshtë e domosdoshme që shoqëria civile të mbështesë shtetin shqiptar për zhvillimin dhe zbatimin e kornizës së monitorimit dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për të zbatuar këtë Axhendë duke përdorur Programin të Aksionit të ICPD dhe rishikimin post 2014 si shtylla orientuese në këtë pëpjekje .

3. Ne gjithashtu inkurajojmë plotësimin e mëtejshëm të punës së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe zbatimin e Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Platformën e Veprimit të Pekinit si dhe marrëveshjet që lidhen me to. Respektimi, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe shëndetit seksual dhe riprodhues për të gjithë duhet të jenë bazat për një axhendë zhvillimi të qëndrueshëm, me kosto-efektive, transformuese dhe efektive në të gjithë dimensionin social, ekonomik dhe mjedisor të kësaj Axhendë.

Ato janë thelbësore për të adresuar pabarazinë, për të zhdukur varfërinë, arritjen e rezultateve në edukim dhe shëndet publik, nxitjen e produktivitetit, pjesëmarrjes së forcave të punës dhe rritjen ekonomike, për të gëzuar frytet nga dividentët demografikë, për

përmirësimin e menaxhimit të mjedisit, energjisë, sigurisë së ushqimeve, ujit dhe higjienës, dhe për të zbutur presionin ndaj burimet e kufizuara dhe ekosistemet”.

Ne inkurajojmë shtetin shqiptar që krahas të gjithë shteteve anëtare të mbështesin Shëndetin seksual dhe riprodhues në Sesionin Special të Asamblesë së Përgjithshme të OKB në 25-27 Shtator.